



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.79/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Byl & Byl” ShPK ,e seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Bajram Morina, avokat nga Gjakova, kundër të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KMMM) me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Pleurat Mata me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.235/22 të datës 27.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.07.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit “Byl & Byl” ShPK ,e seli në Prishtinë e datës 18.12.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.235/22 i datës 27.09.2023, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar është refuzuar në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, “Byl & Byl” ShPK, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit me numër 485 të datës 26.02.2019 të nxjerr nga i padituri Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe të detyrohet i padituri që paditësit t’ia lëshoj licencën për hulumtim të lëndës minerare, metalore në fushën hulumtuese në lokacionet Rahovec, Klinë, Gjakovë dhe Malishevë, sipas kërkesës nr.2434 të datës 14.03.2018 dhe t’ia kompensoj dëmin e shkaktuar në vlerë të përgjithshme prej 1,391,030.00€. Ndërsa, secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me të cilën në tërësi e kundërshton aktgjykimin e ankimuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes esenciale të dispozitave ligjore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale në dëm të paditësit. Me propozim që të aprovohet aprovohet si e bazuar

në tërësi ankesa e paditësit “Byl & Byl” ShPK me seli në Prishtinë rruga “Tahir Zajmi” nr. 38, kurse aktgjykimi i Gjykatës Komerciale në Prishtinë-Dhoma e Shkallës së Parë Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.235//22 i datës 26.02.2023 të Prishtet dhe ndryshohet në dobi të paditësit ashtu që të aprovohet si e bazuar në tërësi padia dhe kërkesa e paditësit nr. 2434 e datës 14.03.2018 për licencim për hulumtim të lëndës minerale metalore në fushën hulumtuese-Hapësirën e cila gjendet shtrihet në lokacionin: Rahovec, Klinë, Gjakovë dhe Malishevë, dhe të detyrohet Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me seli në Prishtinë që paditësit “Byl & Byl” ShPK me seli në Prishtinë, të ia lëshoj licencën për hulumtimin e lëndës minerale metalore në fushën hulumtuese-hapësirën e cila gjendet shtrihet në lokacionin Ivaja, Komuna e Kaçanikut dhe që paditësit në emër të kamatës ligjore vjetore nga dita e parashtrimit të padisë e gjerë në pagesën përfundimtare dhe këtë në emër të fitimit të humbur shumë prej 1,312,930.00€, kurse në emër të kompensimit të shpenzimeve për investime shumë prej 78,100.00€ në tërësi sipas specifikacionit të shpenzimeve të datës 27.02.2019 krejt këtë brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim për përmbarimit me detyrim.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar në drejtim të thënieve në ankesë, përgjigjes në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës në kuptim të nenit 44, par. 1 dhe 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe neni 194 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK),i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me aktvendimin nr.485 të datës 26.02.2019 ka refuzuar në pikën 1. Ka refuzuar kërkesën me numër 2434 të ndërmarrjes Byl Byl ShPK për licencë të Hulumtimit të lëndës minerale metalore, sipërfaqja/hapësira e kërkesës për licencë është në Rahovec dhe gjendet në Komunat e Klinës, Gjakovës Rahovec dhe Malishevë. Në pikën 2. Shfuqizohet aktvendimi nr. protokoli 2596 me të cilin është aprovuar kërkesa 2434 për licencë të hulumtimit në emër të ndërmarrjes Byl & Byl ShPK. Në pikën 3. Në bazë të vendimit të Bordit-Vendimi për ndalim të ri aplikimit nr. 33/2017 ndërmarrjes Byl & Byl ShPK i ndalohet ri aplikimi për një vit nga data e këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi paditësi, ka hapur konflikt administrativ me padi në gjykatë. Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit publik dhe administrimit të provave relevante, si në procesverbalin e seancës për shqyrtim kryesor, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me aktgjykimin e ankimuar me ankesë e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Në arsyetim ndër të tjera ka theksuar se Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur ka refuzuar

kërkesën e paditësit për licencim për hulumtimin e lëndës minerare metalore në fushën hulumtuese, e cila shtrihet në lokacionet Rahovec, Klinë, Gjakovë dhe Malishevë pasi që paditësi nuk ka plotësuar kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr. 03/1—163 për Minierat dhe Minerale (tutje LMM) si dhe nuk dokumentacionin edhe pas zgjatjes së afatit, përkatësisht nuk ka plotësuar kriteret e përcaktuara në nenin 6 par. 1, në-par. 1.4, pika 1.4.1 dhe 1.4.4 të LMM-së Gjykata vlerëson se paditësi nuk ka vepruar, përkundër se me Aktvendimin nr. 2596 të datës 08.08.2018 paditësit i ishte aprovuar kërkesa për Licencë hulumtimi nën kushtin e përmbushjes së obligimeve financiare dhe pastaj me 12.12.2018 përmes parashtrësës ishte njoftuar nga i padituri se nuk i kishte plotësuar kushtet, duke i dhënë afat shtesë prej 15 ditësh për të sjellë dëshmitë mbi burimet financiare dhe të kryej obligimet financiare, mirëpo gjykata gjeti se paditësi ka dështuar të plotësoj kushtet ligjore për licencim sipas dispozitave ligjore, për çfarë gjykata e vlerësoi si të drejtë vendimin e të paditurit për anulimin e vendimit nr. 2596 të datës 08.08.2018. Gjykata konstaton se kërkesat dhe kriteret e dhënies së licencës për hulumtim janë të përcaktuara në nenin 6 të LMM, ndërsa par. 1.4.1 përcakton se: "i posedon burimet financiare dhe është teknikisht i kualifikuar dhe me përvojë për ushtrimin e aktiviteteve sipas Licencës ose Lejes, dhe për zbatimin e detyrimeve të parapara në Licencën ose Lejen në fjalë dhe par 1.4.4 përcakton se: "nëse aplikuesi nuk ka dështuar në përmbushjen e punëve të autorizuar me ndonjë Licencë ose Leje; me kusht që KPMM-ja të mos e refuzojë një kërkesë duke bazuar në dështimin në fjalë, përveç nëse aplikuesi: 1.4.4.. është informuar hollësisht lidhur me dështimin dhe ai nuk ka arritur që ta përmirësojë atë brenda afatit të caktuar nga KPMM-ja, ose 1.4.4.2. në rast se dështimi nuk ka qenë i përmirësueshëm dhe aplikuesi nuk ka ofruar ose paguar kompensim për atë", Sa i përket mungesës së burimeve financiare, gjykata vlerëson se konform nenit 2 par. 1.1 Udhëzimit Administrativ të KPMM Nr.03/2011 - mbi shpenzimet minimale të hulumtimit, shpenzimet minimale janë 50€ për një ha, në rastin konkret paditësi ka ofruar burime financiare në vlerë prej 1,332,990.00€ si dhe zotime për mbështetje financiare nga institucione të ndryshme, Rrjedhimisht gjykata konstatoi se paditësi ka ofruar dëshmi mbi burimet financiare, mirëpo nuk ka përmbushur kushtin sa i përket përmbushjes së obligimeve financiare ndaj KPMM-së. Andaj, duke qenë se paditësi me rastin e aplikimit nuk ka dorëzuar dokumentacionin me të cilin vërteton se plotëson të gjitha kriteret respektivisht kriterin e përmbushjes së të gjitha obligimeve të mëparshme, gjykata konstaton se i padituri me të drejtë ka refuzuar kërkesën e paditësit për licencim për hulumtimin e mineraleve dhe ka shfuqizuar Aktvendimin nr. 2596 të datës 08.08.2018 me të cilin është aprovuar kërkesa nr. 2434 për Licencë të Hulumtimit.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Dhoma e Shkallës së Dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Dhoma e Shkallës së Parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë iu ka referuar

Ligji Nr. 03/L-163, për Minierat dhe Mineralet përkatësisht nenit 84 i cili përcakton se: “Çdo vendim apo veprim i KPMM-së Ministrisë ose cilido autoritet tjetër publik i cili është marrë në bazë të autorizimit të këtij ligji i nënshtrohet edhe shqyrtimi administrativ dhe atij gjyqësor si dhe ankesës, në përputhje me kushtet dhe Procedurat e paraparë në Ligjin për Procedurën Administrative” dhe në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se “Gjykata në konflikt administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative me të cilat organet e administratës në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizik dhe juridik në çështjet administrative”. Andaj, Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka konstatuar se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga i padituri në procedurë administrative dhe në kundërshtim me provat e administruara në këtë çështje, pasi që paditësi nuk i është përmbajtur kushteve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet si dhe nuk ka dëshmuar me burime të mjaftueshme financiare për ekzekutimin dhe ushtrimin e aktiviteteve sipas licencës. Andaj, kolegji vlerëson se në këtë rast e paditura i ka dhënë afate shtesë për plotësimin e kushteve për licencim, mirëpo paditësi nuk ka përmbushur me kohe të gjitha obligimet financiare.

Në raport me pretendimet e paditësi se aktgjykimin të atakuar i mungojnë arsyet-argumentet ligjore dhe faktike për refuzimin e kërkesëpadsisë së paditësit dhe se dispozitivi i aktgjykimin të atakuar me ankesë është në kundërshtim me arsyetimin, kontradiktor me vet veten se ka kundërthënie në mes të fakteve të palëve në procedurë se nuk janë dhënë arsyet për faktet vendimtare, por se ato janë dhënë të paqarta me çka vërtetohet se Dhoma e Shkallës së Parë nuk ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore në fuqi, me çka mos zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi ka pasur ndikim në nxjerrjen e aktgjykimin të atakuar me këtë ankesë në dëm të debitorëve. Dhoma e Shkallës së Dytë konstaton se Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë ka konstatuar se paditësi nuk ka plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet si dhe nuk ka plotësuar dokumentacionin edhe pas zgjatjes së afatit, përkatësisht nuk ka plotësuar kriteret e përcaktuar në nenin 6 par 1 nën par 1.4 pika 1.4.1 dhe 1.4.4 të LMM-së, i cili përcakton kërkesat dhe kriteret e dhënies së licencës për hulumtim. Po ashtu Udhëzimi Administrativ nr.03/2016 për Taksa administrative neni 7 par.1 dhe 2 përcakton se: taksa/pagesa vjetore për realizimin e veprimtarisë së licencuar është taksë vjetore që duhet ta paguaj çdo bartës i licencës/lejes pas marrjes së saj. 2. Pagesa e kësaj takse bëhet nga i licencuari në dy forma 2.1 në fillin të çdo viti kalendarik apo 2.2 përmes ratave mujore për të cilat është arritur marrëveshja me KPMM-në (marrëveshja duhet të jetë me shkrim dhe bëhet me kërkesa të licencuarit, ku në pikën 5 është përcaktuar obligimi për mirëmbajtje vjetore për një licencë hulumtuese në shumë prej 1,400€. Andaj, kolegji vlerëson se paditësi edhe pse ka qenë i njoftuar dhe i është dhënë afat shtesë për plotësimin e kushteve për licencim, nuk ka përmbushur me kohë të gjitha obligimet financiare, respektivisht nuk ka kryer pagesën e taksës vjetore administrative ndaj të paditurit.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata ka vendosur në kundërshtim me dispozitat e nenit 182 paragrafi 1 dhe neni 182 paragrafi 2 pika n) të LPK-së si dhe ka aplikuar gabimisht të drejtën materiale në dëm të paditësit të definuar sipas dispozitave të nenit 184 të LPK-së të aplikueshme në Procedurën përmbartimore në bazë të dispozitave të nenit 17 të LPP-së. Këto pretendime ankimore kolegji i refuzon si të pa bazuara pasi që kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore. Andaj, për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, dhe Dhoma e Shkallës së Parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, ngase paditësi me asnjë fakt të vetëm nuk e ka bërë të besueshëm se ankesa e tij është e bazuar. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të padisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mundë të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.79/24, me datë 18.07.2024

**Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami**